

Abstrakt

Një kushtetutë demokratike në shoqëri, e cila ka parimet dhe rregulla e veta që kufizojnë pushtetin, proklamojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, parasheh ndarjen e pushteteve dhe vlera tjera demokratike, ka qenë dhe vazhdon të jetë e nevojshme për funksionimin e një shtetit, realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të qytetareve ndaj shtetit dhe anasjelltas. Fati i shqiptarëve të Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi për të realizuar vullnetin e tyre ka zgjatur me shekuj dhe me sfida të shumta, sfida me të cilat ende përballen.

Në këtë punim paraqitet historiku i konstitucionalizmit në Kosovës, në periudha të caktuara, zhvillimet që kanë ndodhur e që kishin ndikim në pozitën kushtetuese të Kosovës.

Pasqyrohet rezistenca e shqiptarëve të Kosovës dhe kërkesa e tyre për realizimin e të drejtës së vetëvendosjes si e drejtë ndërkombëtare e popujve. Pra mes tjerash trajtohet rëndësia e parimit të vetëvendosjes së shteteve dhe proceset tjera historike që ndërlidhen me këtë parim.

Punimi është i strukturuar në tre kapituj, secili veç e veç përmban një periudhe kohore të caktuar vitesh lidhur me pozitën kushtetuese që kishte Kosova ndër vitesh.

Në kapitullin e parë është shtjelluar nocioni i konstitucionalizmit, historiku i konstitucionalizmi në Kosovë nga viti 1943 deri në vitin 1974 dhe ndryshimet kushtetuese gjatë këtyre viteve. Kjo periudhe është përzgjedhur që të trajtohet paraprakisht në këtë kapitull pasi ka ndikim dhe ndërlidhshmëri në procesin e mëtejshëm për liri dhe pavarësi të popullit shqiptar dhe pozitën kushtetuese të Kosovës.

Në kapitullin e dytë, është trajtuar pozita kushtetuese e Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974. Theksohet cila ishte Pozita Kushtetutës e Kosovës e ndryshuar dhe cilat ishin shkaqet që ndikuan në avancimin dhe ndryshimin e këtij pozicioni kushtetutës.

Kurse, në kapitullin e fundit shtjellohen veprimet juridike-kushtetuese dhe politike që u ndërmori Kosova pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë lidhur me pozitën e saj kushtetuese dhe zhvillime tjera të rëndësishme politike që përfshijnë një periudhë 10 vjeçare e që kanë vulosur fatin e shqiptarëve të Kosovës. Po ashtu, përshkruhet dhe ndikimi i faktorit ndërkombëtare në këtë periudhë.

Fjalët kyqe : KONSTITUCIONALIZEM, POZITË KUSHTETUESE, LIGJ KUSHTETUTES, KUSHTETUTA E VITIT 1974, PARIMI I VETËVENDOSJES, REPUBLIKA E KOSOVËS, LIRI, PAVARËSI, REPUBLIKA SOCIALISTE FEDERATIVE E JUGOSLLAVISË, REPUBLIKA SOCIALISTE E SERBISË, LDK, UÇK, NATO, LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT.